

**ENTI RREGULLATOR I ENERGISË**  
**Bordi****VENDIM****Nr. 3, Datë 17.01.2018****MBI****REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË MTC ENERGY SH.P.K., PËR  
VENDOSJE HIPOTEKE DHE BARRË MBI ASETET E SHOQËRISË “M.T.C  
ENERGY” SH.P.K, PËR EFEKT TË RISTRUKTURIMIT TË KREDISË NË FAVOR  
TË RAFFEISEN BANK SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16; nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; pikës 1.3 të “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 11 të “Rregullore të Procedurave të Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 119, datë 21.07.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullave për Organizimin Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me transferimin e asetëve të shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k., për lënie peng në favor të Raffeyen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën e protokolluar në ERE në datën 26.12.2018 shoqëria “M.T.C Energy” sh.p.k., ka depozituar në ERE, kërkesën për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “M.T.C ENERGY” sh.p.k, për efekt të ristrukturimit të kredisë në favor të Raffeyen Bank sh.a dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 29 Prot., datë 10.01.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacion plotësues për aplikimin e tij. Po ashtu edhe Raffeyen Bank sh.a më shkresën e protokolluar në ERE me nr. 29/1 Prot., datë 10.01.2019, ka përcjellë deklaratën nr. 614, datë 08.01.2019 dhe atë nr. 615, datë 08.01.2019, në funksion të këtij aplikimi.
- Kontrata e kredisë bankare nr. 4887 Rep, nr. 2475 Kol, datë 07.11.2016, që ndryshon kontratën nr. 4085 Rep., nr. 1778 Kol, datë 28.09.2012, e paraqitur nga subjekti në ERE, nuk parashikon barrësim apo lënie hipotekë të asetëve të të licencuarit, por vetëm ndryshimin e monedhës së përdorimit të linjës së kredisë dhe normës së interesit dhe dispozita të tjera që nuk shpreh për asetet e të licencuarit.
- ERE në zbatim të nenit 44 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, dhe “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve fikse nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 119, date 21.07.2016 të Bordit të ERE, shprehet vetëm për transferim të licencës ose të asetëve nga të licencuarit dhe jo për

ristrukturim kredie (kolateral financiar). Si e tillë nuk është në kompetencën e ERE shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “M.T.C ENERGY” sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “M.T.C ENERGY” sh.p.k, për efekt të ristrukturimit të kredisë në favor të Raffeisen Bank sh.a.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut do të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**